



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspektionit
Glllogoc, më 05.06.2019



RAPORT PËR MUAJIN MAJ 2019

Gjatë këtij muaji të gjithë inspektorët kanë kryer punët sipas lëmive përkatëse fillimisht në shqyrtimin e kërkesave të qytetarve në të gjithë sektoret, pastaj kanë vazhduar inspektimin sipas sektorve. Në sanitari subjektet afariste hoteliere, sallonet e ondulimit, në komunikacion transportuesit legal, në treg ekspozimi i artikujve jashtë lokali, në mjedis hyrja në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, si dhe në ndërtim

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

SEKTORI SANITAR

Gjatë muajit Maj me rëndësi të veçantë janë inspektuar subjektet afariste hoteliere rreth kushteve higjienike dhe sanitare, në ato subjekte që kemi hasur në parregullsi është urdhëruar për përmirësim të tyre. Pas rastit të epidemisë me salmonellozë në subjektin “Toni” në Drenas, subjekti në fjalë është mbyllur dhe janë marrë të gjitha masat e nevojshme sanitare deri në përmirësim të kushteve. Pastaj janë inspektuar sallonet e ondulimit në Drenas dhe Komoran për kushtet higjienike, duke urdhëruar për tu pajisur me libreza sanitare dhe ngritje të nivelit të higjienës. Gjithashtu është vazhduar me inspektim të shkollave në Komunën e Drenasit dhe është bërë raportim i veçantë për to.

SEKTORI I NDËRTIMIT

Janë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veçanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit dhe ndërtimet që bëhen në pronën komunale. Gjatë zhvillimit të procedurave janë hartuar procesverbale të inspektimit, aktvendime, njoftime dhe përgjigje ndaj kërkesave.

SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Janë bërë 63 inspektime të transportuesve legal me kërkesën e policisë sipas agjendës së tyre në bashkëpunim me njësinë e policisë së Drenasit dhe trafikut regjional.

SEKTORI I TREGUT

Janë inspektuar bizneset të cilat kanë ekspozuar artikujt jashtë lokali, shqyrtimi i kërkesave për dhënjën e pëlqimit për ushtrimin veprimtarisë, kontrollimin e artikujve ushqimor dhe afatet e përdorimit.

SEKTORI I MJEDISIT

Janë bërë inspektime në lëmin e mjedisit, shqyrtimi i kërkesave të palëve , bizneseve për hyrje në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, për ujra të zeza , si dhe inspektim rutinor në mjedis për marrjen e masave për ndonjë parregullsi eventuale

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin Maj 2019

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Gjoha mandatore	Fletëparaqitje	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Njoftime	Raporte	Kërkesa	Kallxime penale	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit pa afat
Sanitari	38	2	1	1	1	1	0	0	0	0	3	1	0	0
Treg	27	2	9	0	5	2	0	0	1	0	1	0	0	1
Komunikacion	5	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Ndërtim	40	2	1	1	0	0	2	4	1	2	3	0	0	0
Mjedis	32	1	2	0	0	0	1	0	1	0	1	0	0	0
Totali	142	7	14	2	6	3	3	4	3	2	8	1	0	1

Maj ,2019

UD shef i Inspekcionit: Haki Bekolli